



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2021:270638

Datë: 06.06.2024

Numri i dokumentit: 05787795

C.nr.1251/21

GJYKATA THEMELORE NË PRZIREN – DEGA NË SUHAREKË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Selajdin Gallapeni, si dhe pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Labinot Demiraj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R. G nga S, të cilin me autorizim e përfaqëson i autorizuari Xh. B, avokat nga P, ndaj të paditurës K e S – D e A, të cilën e përfaqëson sipas akt emërimit përfaqësuesi ligjor A. B nga S, për shkak të kompensimit mbi bazën e kualifikimit, / licencimit dhe inflacionit në pagë me datë 06.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- Pa Shqyrtim Kryesor të çështjes -

- I.** APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit R. G nga S, ashtu që DETYROHET e paditura K e S, D e A në S, që paditësit në emër të gradimit/licencimit, nga data 02.12.2018 e deri më datë 21.11.2022, gjegjësisht për (47 muaj e 21 ditë), t’ia paguaj shumën prej 2.640.19 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e parashtrimit të padisë (02.12.2021), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nën pasojat e përmbarimit të detyrueshëm.
- II.** REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë në lidhje me kompensimin në emër të gradimit/licencimit dhe atë për periudhën nga data 18.04.2017 e deri me datë 01.12.2018, për shkak të parashkrimit.
- III.** HEDHET poshtë pjesa tjetër e kërkesëpadisë lidhur me kompensimin në lidhje me përfshirjen e inflacionit në pagë, për periudhën 18.04.2017 e deri me datë 21.11.2022, si e palejueshme.
- IV.** DETYROHET e paditura K e S, t’ia kompensoj paditësit shpenzimet e procedurës në vlerë prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në të kundërtën nën pasojat e

përmbartimit të detyrueshëm, ndërsa pjesa tjetër përtej shumës së aprovuar në lidhje me shpenzimet si në këtë pikë të dispozitivit REFUZOHET.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të saj Av. Xh. B, ka parashtruar padi më 02.12.2021 pranë kësaj gjykatë kundër të paditurës K e S –D e A, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e shtesave në pagë mbi bazën e kualifikimit – licencimit për shkak se e paditura K e S, nuk ka vepruar konform Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, i njëjti ka shtuar se i jemi drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensimin e kësaj forme të shtesës në pagë dhe tani e paditura e ka refuzuar kërkesën edhe pse praktika gjyqësore po e aprovon këtë formë të kompensimit.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën për precizimin e padisë të datës 12.12.2023 ka bërë precizimin e padisë në aspektin objektiv me të cilën ka kërkuar për paditësin edhe shpenzimet e inflacionit në pagë ndër vite.

E paditura K e S– DKA, përmes të autorizuarit të saj theksuar se sa i përket kërkesës për kompensim e kualifikimit arsimor – avancimit në karrierë e kundërshtojmë në tërësi si të pabazuar për shkak se në rastin konkret paditësi ka nënshkruar një kontratë të punës ku janë paraparë të drejtat dhe detyrimet e në mesin e tyre edhe paga, duke llogaritur edhe gradimin në shumën e caktuar si në kontratën bazë. Po ashtu ka theksuar se paditësit nuk kanë licencë valide dhe gjithashtu është thirrur në institutin e parashkrimit , përkatësisht në nenin 87 të Ligjit të punës, prandaj në fund ka theksuar se i propozojmë gjykatës që kërkesëpadinë e gjykatës të e refuzoj si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, precizimit të kërkesëpadisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitura nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është **pjesërisht e themeltë**, sa i përket kompensimit në emër të gradimit, ndërsa në lidhje me shpërblimin e inflacionit në pagë, gjykata e refuzoi për faktin se është çështje e gjykuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes kontratën e punës me nr.78/19 të datës 27.09.2019.

Kontestuese në mes të palëve ishte nëse paditëse është kompensuar në tërësi në emër të gradimit dhe nëse i njëjti është i pajisur me licencë valide, të cilat i lëshon Ministria e Arsimit.

Faktin e licencimit të mësimdhënësit, gjykata e vërtetoi përmes Licencës së Mësimdhënësit me nr.100010821, nga e cila gjykata vërteton faktin se paditësi është i pajisur me licence të rregullt karriere me datë të lëshimit 01.03.2013, ndërsa sa i përket pretendimit të palës së paditur se paditësi është kompensuar në emër të licencimit gjykata konstaton se i njëjti është kompensuar në shumën prej 58.32 euro për çdo muaj, ku këtë fakt gjykata e vërtetoi nga lista pagave, ndërsa nuk i është paguar diferenca në shumën prej 55.35, të cilën shumë gjykata ia ka llogaritur për periudhën aprovuese si në pikën një të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në bazë të Vendimit Nr.01/33, datë 29.08.2008, gjykata gjeti së Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 29 gusht 2008, ka marrë vendim, ku sipas pikës 3 të këtij vendimi përcaktohet se “ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në nivelin fillorë dhe atë të mesëm bëhet në bazë të kriterëve të licencimit, si: përgatitja profesionale (kualifikimi) dhe përvoja e punës”.

Ndërsa në pikën 4 theksohet se, citojmë: *Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët), dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur:*

- 1) *Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10 %;*
- 2) *Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19 %;*
- 3) *Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27 %;*
- 4) *Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë), përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.*

Sipas nenit 7 par. 1, pika 1.1, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë 01B-Nr.prot.2056, e cila ka hyrë në fuqi nga data 18.04.2017, është paraparë së “*Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit.*

Për me tepër, siç është cekur edhe me sipër, e drejta për pagesë shtesë për licencim në, vlerën 27% për mësimdhënëses me diplomë fakulteti.

Gjykata deri te shuma aprovuese për gradim erdhi duke ia shumëzuar pagën bazë të paditësit me 27 % për shkak se ka përfunduar studimet bachelor, shuma të

cilën e ka siguruar në bazë të gradimit, duke arritur te periudha aprovuese më saktësisht sipas kësaj formule: (paga bazë 421.00 euro x 27% =113.67 euro– 58.32 të cilat i ka siguruar paditësi gjatë marrëdhënies së punës = 55.35 euro diferenca e papaguar x 47 muaj e 21 ditë për të cilët i takon të i njihet diferenca e papaguar = 2.640.19 euro)

Gjykata vendosi si në pikën dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazua në deklaratimet e palës së paditur në përgjigje në padi, e cila ka theksuar nder të tjera se po ashtu kemi të bëjmë me parashkrim, duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, i cili thotë se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para , parashkruhen brenda afatit prej tre vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Bazua nga interpretimi i kësaj dispozite gjykata konstaton se padia e paditësit është paraqitur me datë 02.12.2021, e nëse kthehemi tre vite mbrapa atëherë i bie që kërkesëpadia e paditësit është brenda afatit vetëm sa i përket periudhës nga data 02.12.2018, pra afatit tre vjeçar, ndërsa pjesa tjetër ka arritur afatin e parashkrimit.

Ndërsa sa i përket vendosjes si në pikën e tretë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata ka gjetur se në lidhje me shpërblimin e inflacionit në pagë, paditësi është kompensuar për sipas Aktgjykimit C.nr.268/22, i datës 29.11.2023, për periudhën e njëjtë të cilën e ka kërkuar kompensimin në këtë çështje, pra deri me datë 21.11.2022, me çka gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 166.2 i LPK-së, ku thuhet se, citojmë *“Gjykata gjatë gjithë procedimit të çështjes kujdeset sipas detyrës zyrtare se a mos është gjë e gjykuar çështja e ngritur me padi dhe nëse konstaton se procedura është iniciuar për kërkesën për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, padia duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.”*, të ndërlidhur me nenin 391, *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: “d) çështja është gjë e gjykuar (res iudicata)”*, pra bazuar nga kjo gjendja faktike si dhe interpretimi i dispozitave ligjore, gjykata konstaton se kërkesëpadia e paditësit në lidhje me futjen e inflacionit nder vite në pagë duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenin 382 të LMD-së, sipas të cilës dispozitë është paraparë së *Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*, dhe si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës gjykata ka caktuar datën paraqitjes së padisë.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë, shumë prej 104.00 euro, për taksë gjyqësore për padi, shumën prej 20.00 euro, (sipas tarifës së Odës së Avokatëve) në shumën të përgjithshme

prej 124.00 euro. Ndërsa pjesën tjetër të kërkuar nga pala paditëse – i autorizuar i saj në shumën prej 104.00 euro për precizimin e padisë, gjykata e refuzoi për faktin se precizmi i padisë është bërë pa kërkesën e gjykatës.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat e në kuptim të nenit 152 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS
SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:270638, 06.06.2024**

G j y q t a r i

Selajdin Gallapeni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.